



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:120263
Datë: 29.05.2023
Numri i dokumentit: 04335752

SCC-09-0063

Paditësi

N (V) K i biri i të ndjerit V S. K Komuna e G

Kundër

E paditura

K “ K” – Lipjan nën administrimin e Agjencionit Kosovarë të Privatizimit, lagja
Lakërishte- rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Hajrije Shala gjyqtare kryesuese, Gazmend Sylaj dhe Hasim Sogojeva, gjyqtarë, pas seancës dëgjimore të mbajtur me 25.05. 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Padia hedhet poshtë si e papranueshme.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për paditësin**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi në 28.04.2009 ka parashtruar padi për kthimin e paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 0.77,29 ha dhe bartjen e drejtës së pronësisë pranë Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Paditësi me këtë padi ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N K (V), nga KK Prishtinë, dhe të vërtetohet se paditësi N K (V) është pronarë i parcelave kadastrale nr.1687, me sipërfaqe 0,42.05ha dhe nr. 1691, vendi i quajtur “O”, me kulturë arë e klasit të IV, në sipërfaqe prej 0,62.29 ha, në bazë të mbajtjes e që i padituri është i detyruar të pranoj, që paditësi ta regjistroj te drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë e kthyer dhe t’i kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Në mbështetje të padisë ka bashkangjitur kërkesën e paditësit të drejtuar Drejtoratit të pronës në KK Prishtinë të dt. 03.01.2009, vendimin e dt. 09.10.1963 dhe vendimin e vitit 1964 të KK të Prishtinës - Komisionit për arondim .

Me dt. 07.11.2017 e paditua AKP ka parashtruar mbrojtje në padi me të cilën thekson se e konteston në tërësi kërkesë padinë e paditësit N K duke theksuar se me provat e prezantuara në padi nuk mund të verifikohet asnjë fakt me rëndësi për vendimmarrje nga ana e gjykatës. Kjo padi nuk përmban kriteret e nevojshme që i parasheh neni 27.2 i shtojcës së ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme. Nga provat që gjinden në shkresat e lëndës nuk argumentohet asnjë fakt i rëndësishëm për këtë kontest siç janë: - legjitimiteti aktiv dhe pasiv i te paditurës.

Nga provat e prezantuara nuk mund të vërtetohet se paditësit me të paditurën kanë pasur raporte pronësore juridike, nga të cilat mund të vërtetohet se e paditura në mënyrë të kundërligjshme e ka dëmtuar apo privuar nga e drejta e pronësisë paditësin, në tokën për të cilën tani ka paditur. Shpronësimi i çfarëdo llojit, ka qenë kompetencë e organit Shtetëror (Komunës), ndërsa ajo me vendim e ka bartë të drejtën e pronësisë apo të shfrytëzimit tek NSh-të. Nga kjo vërtetohet fakti se e paditura është bërë pronare sipas nenit 20 të LTHMPJ-së GZJ 6/80, ligj ky i cili ka përcaktuar formën e fitimit të drejtës së pronësisë. Në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë historiat apo sqarim nga i cili do të vërtetohej se kjo pronësi e paraardhësit të paditësve ka qene e evidentuar ne emër te tij dhe si ka kaluar ne emër te paditurës.

Aktvendimi me nr. 24638/63 dt. 04.12.1963 dhe 507/64 i dt. 20.10.1964 të Komisionit për arondim pranë Komunës së Prishtinës ka qenë dokumente të mjaftueshëm për ti realizuar ndërrimet në kadastër.

Në fund fare AKP propozon që padia e paditësit N K, nga Komuna e G për aprovimin e padisë së tij dhe anulimin e aktvendimit me nr.24638/63 dt. 04.12.1963 dhe 507/64 o dt. 20.10.1964 të Komisionit për arondim pranë Komunës së Prishtinës, të refuzohet si e pa bazuar. Toka ka qenë objekt i këtyre procedurave si ngastra kadastrale me nr. 1687 me sipërfaqe 0.42.05 ha dhe ngastra me nr.1691 me sipërfaqe prej 0.62.29 ha kulturë ara te kl.4 që gjinden në vendin e quajtur “O” t’i kthehen në pronësi dhe posedim.

Me 16 maj 2023, gjykata ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën ka prezentuar S K i biri i N K i cili deklaroi se babai i tij ka ndërruar jetë me dt. 08.08.2008, ndërsa gjyshi i tij nuk është V siç shkruan në padi por V. Sa i përket padisë ai shtoi se babai i tij ka ushtruar një padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe së bashku me te kanë qenë në atë seancë në muajin mars apo prill të

vitit 2003 dhe nuk kanë pasur përfaqësues – avokat. Ndërsa, avokatin B E e njëj sepe ai në vitin 2004-2005 ka marr pjesë në një takim me drejtorin e K të G për kthimin e pronave të familjes së tij dhe banorëve për rrethe që kanë pas probleme me kthim të pronës. Njëherit mori obligim ta sjellë certifikatën e vdekjes së babait.

Gjyqtarja Kryesuese konstaton se pranë kësaj gjykate është pranuar padia më dt. 28.04.2009 që është 8 muaj pas vdekjes së personit që ka ushtruar padinë.

Në seancë u konstatua që kemi të bëjmë me një padi e cila është parashtruar nga personi i vdekur dhe nënshkruar dhe dorëzuar në kohën kur ai ka vdekur. Si rezultat i rrethanave të paraqitura kjo padi konsiderohet e pa pranueshme për shkak se është nënshkruar nga një person i cili nuk jeton.

Gjyqtarja kryesuese obligon palën prezentë që në afat prej 7 ditësh ti dorëzoj gjykatës certifikatën e vdekjes së babait të tij N K respektivisht paditësit të kësaj lënde, nëse certifikata e vdekjes nuk dorëzohet brenda afatit të cekur më lartë gjykata do të marrë si të mirëqenë datën e vdekjes të cilën pala prezentë e deklaroj në seancë.

Me dt. 25.05.2023 është pranuar në Gjykatë përmes postës, një kopje e certifikatës së vdekjes së N K këtu paditësi, e dërguar nga djali i tij S K.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit konsiderohet e pa-pranueshme.

Fillimisht, sipas nenit 32 paragrafi 1 i Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086), paditësi/t pranë DHPGJS mund të përfaqësohet/n vetëm nga personi i cili është avokat dhe i cili duhet të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës.

Tutje sipas nenit 36 paragrafi 2.5 i Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086) parasheh se një padi/ankesë/kërkesë konsiderohet e pranueshme nëse kërkesa/ankesa/padia është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji.

Neni 33.1 i Ligjit për DHPGJS, parasheh se origjinali i çdo parashtruese, me rastin e dorëzimit në Gjykatë, duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues të autorizuar, por në cilësinë e avokatit. Sipas kësaj dispozite, parashtruesi në këtë rast, duhet:

- a. që kërkesën/padinë/ankesën me rastin e parashtrimit pranë Gjykatës ta nënshkruaj personalisht, dhe
- b. nëse kjo parashtruese parashtrohet dhe nënshkruhet nga ana e përfaqësuesit atëherë së bashku me kërkesën, si në rastin konkret, të nënshkruar të dorëzoj kopjen e autorizimit por që të dëshmoj se është avokat anëtar i Odës së Avokatëve.

Në rastin konkret avokati – përfaqësuesi i paditësit i tani të ndjerit N K, pran gjykatës ka dorëzuar autorizim e nënshkruar nga paditësi, të cilin si të tillë e kontestoi trashëgimtari-djali i të ndjerit N K- S K dhe në seancë dëgjimore mohoi se babai i tij i ndjer ka ushtruar padi në Dhomën e posaçme dhe është i befasuar për ftesën që e ka marr për seancë.

Sa i përket avokatit B E ai theksoi se i njëjti paska ushtruar padi pa dijen e tyre dhe se nënshkrimi në padi nuk është i babait të ndjer.

Gjykata vlerësoi deklaratimet e djalit të tani të ndjerit N K dhe duke krahasuar e analizuar me kohën e dorëzimit të padisë në Gjykatë gjeti se, padia është e pa -pranueshme sepse djali i tani të ndjerit në tërësi e mohoi faktin se babai i tij të ketë ushtruar padi në Dhomën e Posaçme për ndonjë parcelë kontestuese.

Me dt. 25.05.2023 S K përmes postës ka dorëzuar një kopje të certifikatës së vdekjes së babait të tij N K-këtu paditësi, ku vërtetohet se i njëjti ka ndërruar jetë me dt. 08.08.2012, ashtu që edhe pse kjo datë nuk përputhet me datën që S K e përmendi në shqyrtimin gjyqësor për vdekjen e babait - paditësit N K, për Gjykatën ishte vendimtar deklarimi kur mohoi faktin se babai i tij asnjëherë nuk ka ushtruar padi pranë DHPGJS-së.

Andaj, nga gjitha arsyet, në pajtim me nenin 36 paragrafi 2.5 të DHPGJS, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 59 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS, mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese

Gazmend Sylaj, Gjyqtar

Hasim Sogojeva, Gjyqtar

Numri i lëndës: 2023:120263
Datë: 29.05.2023
Numri i dokumentit: 04335752